



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**  
**KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË**

Tiranë, më 12.04.2021

Dokument parlamentar

*(Komision për dhënie mendimi)*

**RAPORT**

**PËR**

**Aktin normativ nr. 9 datë 23.03.2021 “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, ministrit të shtetit për rindertimin dhe institutit të shëndetit publik dhe distributorit të autorizuar "Keymen ilac sana yi ve ti caret", a.s, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinen e inaktivizuar kunder covid-19 (vero cell) coronavac, të krijuar nga sinov ac life science co, ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës"**

***I. Hyrje***

Akti normativ nr. 9, datë 23.03.2021 “Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindertimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "Keymen ilac sana yi ve ti caret", a.s, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinen e inaktivizuar kundër covid-19 (vero cell) coronavac, të krijuar nga sinov ac life science co, ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës". është propozim i Këshilli i Ministrave.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit. Relator për këtë Akt Normativ ishte znj. Edlira Bode. Të ftuar gjatë mbledhjes së Komisionit ishin dhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Social, më konkretisht Zv/ministria znj.Mira Rakacolli, Sekretarja e Përgjithshme znj. Geraldina Prodani dhe Drejtoresha Juridike znj.Antoneta Njehrrera.

Ky akt normativ nuk është planifikuar në planin e përgjithshëm analitik të projektakteve të vitit 2021.

## ***II. Baza ligjore Kushtetuese***

Akti normativ i Këshillit të Ministrave është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, neni 101 të saj.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

## ***III. Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e aktit normativ.***

### ***Qëllimi***

Qëllimi i këtij akti normativ është parandalimin e infektimit me Sars-Cov-2 të popullatës.

Me anë të këtij akti normativ synohet të miratohet teksti i marrëveshjes ndërmjet ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindertimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "Keymen Ilar; Sanayi ve Ticaret", A.S.

Distributori i autorizuar "Keymen Ilar; Sanayi ve Ticaret", A.S. paraqiti autorizimin e marrë nga kompania Sinovac Life Science Co, Ltd., i cili është i vlefshëm nga data 15.2.2021 deri 31.12.2021.

### ***Risitë***

Nevoja dhe urgjenca janë parakushte të domosdoshme për nxjerrjen e një akti normativ. Pandemia aktuale e shkaktuar nga Sars-Cov-2 (Covid-19) ka shkaktuar dëme të mëdha në shëndetin e njerëzve, duke kaluar deri në humbjen e jetës dhe dëme ekonomike qoftë për buxhetin e personave të prekur, qoftë për buxhetin e bizneseve për shkak të vendosjes së masave kufizuese të frekuentimit të tyre, ashtu si dhe dëme në buxhetin e shtetit, duke kaluar fokusin më të madh në investimet në shërbimet shëndetësore, kryesisht spitalore.

Situata e krijuar nga Sars-Cov-2 vlerësohet e pamundur të presë aq kohë sa nevojitet për nxjerrjen e ligjit të nevojshëm nga organi ligjvënës, qoftë edhe nëpërmjet procedurave të përshpejtuara.

Nevoja për një vaksinë kundër Sars-Cov-2 është imediate për rivendosjen e ekuilibrit normal social dhe ekonomik.

Ky akt normativ, pas miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave, i nënshtrohet, brenda afatit kushtetues, dërgimit për miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

### ***Përmbajtja e aktit normativ***

Akti normativ permban parashikimet e mëposhtme:

## Neni 1

### Miratimi i tekstit të marrëveshjes

1. Miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar "Keymen Ilac; Sanayi ve ticaret", A.S, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell) Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

2. Marrëveshja për furnizimin, ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe "Keymen Ilac; Sanayi ve ticaret", A.S për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga "Keymen Ilac; Sanayi ve ticaret" nuk do të publikohet në asnjë ëëbsite të institucioneve apo në "Fletoren zyrtare".

3. Te gjitha institucionet e përfshira në dhenien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

4. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksines anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr.1, datë 10 . 1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për furnizimin e vaksines së inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell), Coronavac të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, të furnizuar për Shqipërinë nga Keymen Ilac Sanayi ve ticaret A.S, sipas kushteve të tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij akti normativ.

## Neni 2

### Efektet financiare

Efektet financiare, që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, perballohen nga fondi rezerve i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

## Neni 3

### Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

## ***IV. Efektet financiare***

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shoqërohet me efekte financiare të cilat do të perballohen nga fondi rezerve i buxhetit të shtetit.

## ***V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.***

Akti normativ u prezantuar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, Zv/Ministria znj. Mira Rakacolli, ku ndër të tjera theksoj se vaksinimi i popullsisë është një ndër

prioritetet e qeverisë në këtë kohë për menjanimin sa më të madhe të përhapjes së virusit Covid -19.

Relatori i Komisionit znj. Bode, në fjalën e saj u shpreh se Akti normativ krijon mundësinë ligjore për rritjen e numrit të të vaksinuarve në Shqipëri. Për rrejdhojë të akteve të miratuara për menaxhimin e pandemisë nga Parlamenti, Shqipëria renditet vëndi i dytë në rajon pas Serbisë për vaksinimin në masë të popullsisë.

Fjalën gjatë mbledhjes së Komisionit për shqyrtimin e këtij Akti Normativ e mori dhe Kryetari i Komisionit z. Roshi, ku theksoj që këto vasina kanë gjetur përdorim në vende të ndryshme të botës, dhe siguria që ato kanë në përdorim është e certifikuar nga vëndet e prodhimit si dhe nga Komitei i Ekspertëve për Imunizim, organ keshillimor i ministrit të Shëndetësisë, parashikuar nga ligji nr.15/2016, "Per parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe semundjeve infektive", te ndryshuar,.

Gjithashtu gjatë fjalës së tij atij shtroi pyetjen për ministrinë nesë kjo vaksinë ka paraqitur efekte anore gjatë përdorimit të saj në popullatë. Në përgjigjen e dhënë nga Zv/ministria znj. Rakacolli u theksua se efektet e vetme anësore që ka shkaktuar vaksina janë dhimbjet e lehta lokale në vëndin e bërjes së vaksinës dhe temperaturë e lehtë në ditët e para të marrjes së saj, efekte që konsiderohen normale për cdo vaksinë që injektohet në trup.

## **VI. Përfundime.**

Në përfundim të shqyrtimit, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë vlerësoi se miratimi i këtij akti normativ në kushtet e nevojës dhe urgjencës, do të ketë impakt pozitiv në mbrojtjen e shëndetit publik, dhe me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi Aktin Normativ nr. 9 datë 23.03.2021 "Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, ndërmjet ministrisë së Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, ministrit të shtetit për rindertimin dhe institutit të shëndetit publik dhe distributorit të autorizuar "Keymen ilac sana yi ve ti caret", a.s, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinen e inaktivizuar kunder covid-19 (vero cell) coronavac, të krijuar nga sinov ac life science co, ltd. dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës".

**RELATOR**

**Edlira BODE**

**KRYETAR**

**Enver ROSHI**